REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes :	71040-00680-11-2017	**Data e Regjistrimit :**	05/05/2017
Numri i Vendimit:	11-2017-4014	**Data e Vendimit :**	28/07/2017

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Rexhep Bekteshi

SEKRETARE: Brunilda Dizdari

Sot më datë 28/07/2017mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Kërkues {....}, i biri i {....} dhe i x, i datëlindjes {....}Kërkues {....}, e bija e {....} dhe i x, i datëlindjes {....} Kërkues {....}, i biri i {....} dhe i x, i datëlindjes {....}

Objekti: Shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë Pranë Gjykates se Shkallës së Pare Durrës te sekuestrimit të transasksioneve, veprimeve bankare, shumat e depozituara në llogari bankare në te gjitha bankat e mvelit të dytë si dhe të gjitha kasetave te sigurise per shtetasit {....},{....} {....}, {....}.

Baza Ligjore: Neni 212/1, 214/2,190/3, 218/3 dhe 301 të K.Pr.Penale.

Në gjykim mori pjesë **prokurorja e çështjes Alma Felaj.**
Gjykata shqyrtoi materialet e çështjes dhe provat e paraqitura nga kërkuesit dhe mbrojtësit e tyre si dhe nga prokurorja Alma Felaj, e në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dëgjoi avokatet mbrojtëse Brunela Kullolli e Mariola Çaushaj, dhe kërkuesin {....}
, **që i kërkuan Gjykatës:**
- Pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e Vendimit të datës 14.04.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës "Për sekuestrimin e transaksioneve, veprimeve bankare e shumave të depozituara në llogaritë bankare në të gjitha bankat e nivelit të dytë, si dhe të kasetave të sigurisë, për kërkuesit {....}, {....} dhe {....}, në zbatim të nenit 210 e vijues të Kodit Procedurës Penale.
Prokurorja e çështjes Alma Felaj në përfundim të shqyrtimit gjyqësor **i kërkoi Gjykatës:**
-Pranimin e pjesshëm të kërkesës dhe heqjen e sekuestrimit të transaksioneve e veprimeve bankare në të gjitha llogaritë bankare, si dhe të kasetave të sigurisë, në të gjitha bankat e nivelit të dytë, në emër të shtetasve, kërkuesve {....} e {....}.
Po kështu, prokurorja e çështjes kërkoi heqjen e sekuestrimit për llogaritë rrjedhëse në emër të kërkuesit (shtetasit) {....}
, si dhe lënien në fuqi të Vendimit të sekuestrimit për depozitat në të gjitha bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesit {....}, që janë vendosur me Vendimin e sekuestrimit të datës 14.04.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

VEREN :

Vëren:
Se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal Nr. 626, i vitit 2017 për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, mbi bazën e materialeve të referuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Durrës.
Nga materiali i mësipërm, del se shtetasi (kërkuesi) {....}, që është vëllai i shtetasit {....}, gjatë viteve 2010 dhe në vazhdim ka kryer transaksione bankare që janë derdhje e tërheqje të shumave monetare të vlerësuara të mëdha. Konkretisht në vitin 2010, transaksionet bankare janë deri në shumën {....} ,ndërsa në vitin 2011-2013, derdhje e tërheqjet dhe ripërtëritje depozitë në banka të ndryshme arrin në shumën {....}, dhe në vitin 2014, ato rezultojnë në shumën {....}.
Po kështu, del se kërkuesi {....} është klient i {....}, që nga muaji mars i vitit 2014, së bashku me bashkëshorten e tij, {....} e gjatë periudhës së vitit 2014 deri në janar të vitit 2017 janë kryer transaksione që kapin shumën totale prej {....}
Kërkuesit (shtetasit) {....} e bashkëshortja e tij, {....}, më datë 11.04.2017, nga kjo bankë kanë lajmëruar tërheqjen e shumës prej {....}, nga llogaria e shtetasit {....} e {....} nga llogaria e shtetases {....}

Nga materialet e çështjes del se në faqen zyrtare të Q.K.B., shtetasit (kërkuesit) {....} e {....}u rezultojnë me 2 biznese **dhe konkretisht**:
a. Subjekti personi fizik me NIPT {....}, i regjistruar në vitin 2008, me objekt veprimtarie: "Investitor në fushën e ndërtimit" i pezulluar në vitin 2014.
b. Subjekti personi fizik me NIPT {....}, i regjistruar në vitin {....} me objekt veprimtarie: "Tregti industriale, grumbul mbetje urbane për qëllim riciklimi përfshi seleksionimin".
Që në fillim të hetimeve me Vendimin e datës 14.04.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, të prokurores Rabiana Halili, është vendosur: "Sekuestrimi i transaksioneve, veprimeve bankare e të shumave të depozituara në llogaritë bankare në të gjitha bankat e nivelit të dytë, si dhe të gjitha kasetave të sigurisë për shtetasit {....}, {....} e {....}, në bazë të nenit 210 e vijues të Kodit Procedurës Penale.
Me Shkresën Nr. 1200 Prot., datë 14.04.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, vendimi i sekuestrimit i mësipërm u është dërguar për veprim të gjitha bankave të nivelit të dytë, që veprojnë (operojnë) në vendin tonë.
Nga materialet e paraqitura në gjykim prej prokurores së çështjes Alma Felaj, del se vendimi i sekuestrimit i datës 14.04.2017 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës është vënë në zbatim nga ana e bankave të nivelit të dytë, që u është dërguar.
Kërkuesit {....}, {....} dhe {....}nuk kanë qenë dakord me vendimin e mësipërm të marrë nga organi i Prokurorisë dhe më datë 05.05.2017 e kanë kundërshtuar atë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, duke shtuar se ai është marrë në kundërshtim me ligjin, dhe kanë kërkuar shfuqizimin e tij, në zbatim të neneve 212 e vijues të Kodit Procedurës Penale.
Në gjykim kërkuesit {....}, {....} e {....} deklaruan se transaksionet bankare e veprimet bankare, shumat e depozituara në llogari bankare, në të gjitha bankat e nivelit të dytë, si dhe të gjitha kasetat e sigurisë, janë përfituar në mënyrë të ligjshme dhe kanë si burim të ligjshëm, aktivitetin privat që ato ushtrojnë në dy bizneset, me objekt veprimtarie: "Investitor në fushën e ndërtimit" dhe të veprimtarisë "Tregti industriale, grumbullimi mbetje urbane për qëllim riciklimi përfshi seleksionimin".
Ato kanë qenë biznese fitim prurëse, dhe të gjitha transaksionet bankare e shumat bankare janë rezultat i veprimtarisë së ligjshme të dy bizneseve, pjesë e të cilëve janë edhe kontratat e porosisë, kthim borxhi, kontratë shitje etj.
Për këtë veprimtari private, kërkuesit {....}, {....} e {....} paraqitën në Gjykatë një sërë provash shkresore, që u administruan në seancë gjyqësore si:
-Vendimi gjyqësor përkatës si person fizik për aktivitetin privat që ushtrojnë të shoqëruar me dokumentacionin përkatës të lëshuar nga organet shtetërore kompetente.
-Kontratën Nr. 1385 Rep. e Nr. 350 Kol., datë 16.07.2003 për pasurinë që shtetasi {....}i ka shitur shtetasit {....}

-Kontratat e sipërmarrjes e datave 16.07.2010; 23.10.2010; 05.04.2011; 17.04.2009; 09.10.2009; 18.04.2009; 21.03.2009; 08.12.2009; 06.04.2010, dhe Kontrata e Shitjes me Kusht Nr. 32 Rep. e Nr. 32/2 Kol., datë 05.01.2009, që Shoqëria e ndërtimit "{....}" sh.p.k. i ka dhënë investitorit, shtetasit {....} të drejtën e shitjes së apartamenteve, dyqaneve e garazheve të objektit godinë e ndërtuar.
-Lejen e Ndërtimit për subjektin ndërtues "{....}" dhe subjektin e tatueshëm {....} e dokumentet e tjera përkatëse, si dhe veprimet konkrete të kryera, që janë të dokumentuara.
-Ekstrakti historik i personit fizik {....} me Nr. {....}, me datë regjistrimi 01.01.2003 me aktivitet veprimtarie "Tregti industriale dhe grumbullimi i mbetjeve urbane për qëllim riciklimi përfshi seleksionimin" si dhe të gjitha pasqyrat financiare të kryera nga ky subjekt.
-Gjithashtu, u administruan dhe provat shkresore e të ardhurave nga biznesi që ushtron shtetasi {....}, nga subjekti "{....}" me NIPT {....}, me veprimtari: "Import, eksport të pajisjeve mjekësore, tregtim artikujsh të ndryshëm, karburante, transport mallrash i udhëtarësh brenda e jashtë vendit tonë, prodhim mallrash inerte, betoni e punime mermeri, si dhe tregti me shumicë e pakicë mallrash, si kafe, pije alkoolike etj."
Në dokumentet e mësipërme janë pasqyruar të ardhurat dhe shpenzimet e kryera si dhe fitimi i realizuar nga viti 2008 deri më 31.12.2016.
Lidhur me shtetasen {....} me Vërtetimin Nr. 64, datë 08.05.2017, del se ajo është e punësuar me kohë të plotë pranë Fondacionit "{....}" dhe ka filluar punë më datë {....}, edukatore përgjegjëse me pagë mujore bruto {....}.
Në gjykim prokurorja e çështjes Alma Felaj, paraqiti si provë shkresore Aktin e Ekspertimit Kontabël të datës 27.07.2017, i ekspertes kontabël i miratuar {....} dhe nga akti i ekspertimit kontabël i mësipërm, del se:
-Me të ardhurat e realizuara ndër vite nga burime të ligjshme të shtetasit {....} e {....} është e mundur që të realizoheshin shpenzimet për blerjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të regjistruar në regjistrat publik, si dhe kryerja e transaksioneve bankare nga ana e tyre.
Po kështu, akti i ekspertimit kontabël i mësipërm ka konkluduar se: Referuar të dhënave të administruara në procedimin penal dhe situatës financiare të paraqitur sa më sipër nga shtetasit {....} e {....}, nuk ka pasuri të pajustifikuara nga burimet e ligjshme.

Prokurorja e çështjes pas administrimit të provave të mësipërme i kërkoi Gjykatës heqjen e sekuestrimit të transaksioneve, veprimeve bankare të shumave të depozituara në të gjitha llogaritë bankare dhe të kasetave të sigurisë, në të gjitha bankat e nivelit të dytë në emër të shtetasve {....} e {....}.
Po kështu, prokurorja e çështjes kërkoi dhe heqjen e sekuestrimit vetëm për llogaritë rrjedhëse në emër të shtetasit {....}
, e lënien në fuqi të sekuestrimit për depozitat në të gjitha bankat e nivelit të dytë, që janë në emër të shtetasit
{....}
Avokatët mbrojtës Brunela Kullolli e Mariola Çaushaj dhe kërkuesi (ankuesi) {....}në përfundim të shqyrtimit gjyqësor i kërkuan Gjykatës: Shfuqizimin tërësisht të Vendimit të sekuestrimit të datës 14.04.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, si të marrë në kundërshtim me ligjin procedural penal.
Gjykata analizoi me kujdes të gjithë provat e faktet e konkludon se kërkesa e bërë nga kërkuesit (ankuesit) {....} u, {....} e {....} duhet pranuar pjesërisht dhe se duhet hequr sekuestrimi i transaksioneve e veprimeve bankare të shumave të depozituara në të gjitha llogaritë bankare e nivelit të dytë, që janë në emër të shtetasve {....} e {....}
Po kështu, Gjykata vlerëson që duhet hequr sekuestrimi vetëm për llogaritë rrjedhëse në emër të shtetasit {....} dhe se duhet lënë në fuqi Vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës i datës 14.04.2017 të sekuestrimit për depozitat në të gjitha bankat e nivelit të dytë në emër të shtetasit {....}.

Për këto arsye

Baza Ligjore:
Në zbatim të neneve 210, 212 e vijues të Kodit Procedurës Penale, Gjykata:

VENDOSI:

Vendosi:
1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës dhe heqjen e sekuestrimit të transaksioneve e veprimeve bankare, të shumave të depozituara, në të gjitha llogaritë bankare, si dhe të kasetave të sigurisë në të gjitha bankat e nivelit të dytë, në emër të shtetasve (kërkuesve) {....} e {....}.
2. Heqjen e sekuestrimit vetëm për llogaritë rrjedhëse në emër të shtetasit {....}, në të gjitha bankat e nivelit të dytë.
3. Lënien në fuqi të sekuestrimit për depozitat në të gjitha bankat e nivelit të dytë, në emër të shtetasit {....} të vendosur me Vendimin e sekuestrimit të datës 14.04.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësore Durrës.
4. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij.
U shpall sot më datë 28.07.2017.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	200
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	200

GJYQTAR:

Rexhep Bekteshi